



Pranimi / Dorezuar Punë/Pracado Received/Issued	24.12.2020	0	viti god year
Organ /Njësia Organ /Zemlja Org /Unit	Pr Prot Pr Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	3298/2020		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.362/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.164/2019 të datës 04.03.2019 dhe ankesën me numër A.nr.362/2020 të datës 18.11.2020 të parashtruar nga ankuesi ██████████ ██████████, me adresë në fshatin “Uglarë” në Komunën e Gjilanit, të bashkuara në një ankesë të vetme me numër A.nr.362/2020, kundër organit të punësimit Komunes së Gjilanit, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa më numër A.nr.362/2020, e datës 18.11.2020 e parashtruar nga ankuesi ██████████ ██████████.
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër 02-016-14031 i datës 07.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit dhe Vendimi me numër 02-016-132008 i datës 13.12.2018 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit.
- III. **ANULOHET** Vendimi me numër 02-101 i datës 12.02.2019 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe Akt Emërimi me numër 02-016/16188 i datës 12.02.2019.
- IV. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Gjilanit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në pozitën “Zyrtar Juridik” në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit ██████████ ██████████, i sistemuar në vendin e punës "Zyrtar Juridik" në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, me datë 20.11.2018 me referencë SH.Z.nr.07-950-125664 Drejtori për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit i Komunës së Gjilanit, paraqet rastin për shkelje disiplinore tek Udhëheqësi i Njesisë së Personelit në Komunën e Gjilanit, të cilën lëndë Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjilanit e ka pranuar me datë 22.11.2018.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjilanit me datë 13.12.2018 nxjerr Vendim me numër 02-016-132008 me të cilin ankuesit ██████████ ██████████ i shqiptohet masa disiplinore *"largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme"*.

Ankuesi ██████████ ██████████, i pa kënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 13.12.2018, me datë 10.01.2019 parashtron ankesën me numër 02-016-2527 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit, i cili me datë 07.02.2019 nxjerr Vendim me numër 02-016-14031 me të cilin refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesit e datës 10.01.2019 dhe mbetet në fuqi vendimi i Komisionit Disiplinor i Komunës së Gjilanit me numër 02Nr.016-132008 i datës 13.12.2018.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, duke e bërë zbatimin e vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 13.12.2018 me numër 02-016-132008, me datë 12.02.2019 nxjerr Vendim me numër 02-101 me të cilin bëhet transferimi i ankuesit ██████████ ██████████ nga pozita "Zyrtar Juridik" në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit më pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, duke i lëshuar Akt Emërimin i cili është nënshkruar më datë 13.02.2019 edhe nga ankuesi.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër 02-016-14031 të datës 07.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit, me datë 28.02.2019 nëpërmjet postës parashtron ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 04.03.2019 dhe protokolluar me numër të protokollit 1153/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Gjilanit. Më datë 21.03.2019 Komuna e Gjilanit, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës.

Për shkak të mosfunksionimit të Këshillit, me datë 22.08.2019, Këshilli ka njoftuar ankuesin se ka të drejtën që të ndjekë procedurën në pajtim me Ligjin për Konfliktin administrative.

Ankuesi më datë 18.11.2020 ka parashtruar serish ankesë me numër protokollit 2626/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me të cilën ka kërkuar që të shqyrtohet ankesa e vitit 2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit të datës 04.03.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 12.02.2019; Vendimi i datës 12.02.2019 për transferimin e ankuesit;

Vendimi i datës 07.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Gjilanit; Procesverbali i datës 29.01.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Gjilanit; Ftesa e datës 24.01.2019 e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Gjilanit; Ankesa e ankuesit e datës 10.01.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Gjilanit; Vendimi i datës 13.12.2018 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Gjilanit; Procesverbali i datës 10.12.2018 mbi shqyrtimin kryesor të Komisionit Disiplinor; Ftesa e datës 06.12.2018 e Komisionit Disiplinor; Njoftimi i datës 23.11.2018; Njoftimi i datës 23.11.2018; Paraqitja e rastit-shkeljes disiplinore e datës 20.11.2018; Vendimi i datës 16.05.2018 me numër 07-350-39623; Vendimi i datës 29.10.2018 i Komisionit Disiplinor; Procesverbali mbi shqyrtimin kryesor i datës 26.10.2018 i Komisionit Disiplinor; Ftesë për seancë e datës 22.10.2018; Njoftimi i datës 08.10.2018; Ankesa e datës 03.10.2018 me referencë SH.Z.nr.07-350-108664; e-mail i datës 01.10.2018; Thirrja e datës 24.07.2018 për [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] Shtojca 2, Nr. serik 00008; E-mail i datës 25.09.2018, 26.09.2018; Kallëzimi penal i datës 23.07.2018; Vendimi i datës 21.05.2017 për anulim të shpalljes për avancim në karrierë; Vendimi i datës 25.07.2017 për anulim të konkursit; Vendimi me numër A.nr.50/2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës "Zyrtar Juridik" ; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018; Ankesa e [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] e datës 25.05.2018 me numër 07-350-51506; Vendimi i datës 16.05.2018 me numër 07-350-35321; Ankesa e [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] e datës 25.05.2018 me numër 07-350-51501; Vendimi i datës 16.05.2018 me numër 07-350-39623; Ankesa e datës 25.05.2018 me numër 07-350-51511 e [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]; Vendimi i datës 16.05.2018 me numër 07-350-35324 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ankesën me numër protokoll 2626/2020 e datës 18.11.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 3/2020 i datës 17.12.2020 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për bashkimin e ankesave të ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në të gjitha provave e lëndës të dërguara nga palët ka konstatuar që ankesa e ankuesit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] është e bazuar, sepse:

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit nuk është personi kompetent për të iniciuar kërkesën për procedurë disiplinore sepse nuk është udhëheqësi i drejtpërdrejt sepse udhëheqës i drejtpërdrejt është Udhëheqësi i Sektorit, andaj procedura disiplinore ndaj meje është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të Shërbimit Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës përkatësisht në bazë të Vendimit të datës 10.02.2017 ka konstatuar se Shefi i Sektorit Juridik në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Gjilanit ka qenë i pensionuar në kohën e inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, ku në mungesë të tij, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit i Komunës së Gjilanit me datë 20.11.2018 ka parashtrua kërkesë tek Njësia e Personelit për fillim të procedurës penale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se e meqenëse Shefi i Sektorit Juridik në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojte të Mjedisit në Komunën e Gjilanit në bazë të Vendimit të datës 10.02.2017 është pensionuar më datës 20.10.2017, atëherë në mungesë të tij Drejtori i Drejtorisë së Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojte të Mjedisit në Komunën e Gjilanit është dashur që rastin për shkelje të supozuar disiplinore nga ankuesi ta paraqes tek udhëheqësi më i lartë administrativ siç përcaktohet me nenin 10 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Çdo shkelje e dyshuar nga nëpunësi civil duhet të paraqitet tek udhëheqësi i drejtpërdrejt ose tek udhëheqësi më i lartë administrativ”*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjilanit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 02-016-132008 të datës 13.12.2018 ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *“largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme”*, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatësisht me nenin 67 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 pika 1.2.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil. Bazuar në këto dispozita ligjore masa disiplinore në fjalë nuk duhet të ndahet siç ka bërë Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjilanit, si dhe është dashur të saktësoj periudhën e largimit nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme, Andaj mbi këtë bazë kolegji konstaton se Vendimi numër 02-016-132008 i datës 13.12.2018 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Gjilanit është në kundërshtim edhe me nenin 47 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativë, i cili përcakton se: *“pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit”*, si dhe nenin 48 paragrafin 2 Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativë, i cili përcakton se: *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Vendimi me numër 02-016-132008 i datës 13.12.2018 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Gjilanit është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, atëherë edhe Vendimi me numër 02-101 i datës 12.02.2019 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe Akt emërimi me numër 02-016/16188 i datës 12.02.2019 janë juridikisht te pavlefshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 02-016-132008 të datës 13.12.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Rregulloren Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar shkeljet procedurale dhe shkelje të ligjit material me rastin e inicimit të procedurës disiplinore ndaj

ankuesit, obligon Kryetarin e Komunës së Gjilanit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në pozitën "Zyrtar Juridik" në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Pasi që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional, ndërsa pas zgjedhjes së pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shqyrtimit të bazës ligjore, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbledhjen e katërt të mbajtur më datë 09.11.2020 nxjerr Vendim me Nr. 9/2020 me të cilin është vendosur që të gjitha ankesat e dorëzuara dhe ato të kthyera në rishqyrtim nga gjykata do të vendosen nga Këshilli. Meqenëse është vendosur që të shqyrtohet edhe ankesat e vitit 2019 atëherë Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.12.2020 bazuar ne nenin 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka nxjerr Vendim me Nr. 3/2020 me të cilin ka vendosur që ankesa me numër A.nr.164/2019 e datës 04.03.2019 dhe ankesa më numër A.nr.362/2020 e datës 18.11.2020 të parashtruara nga ankuesit Bashkim Isufi të bashkohen në një ankesë për shkak se bazohen në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.


Kështu që secila palë që ka mundur të hap konflikt administrativ si pasoj e mos veprimit të KPMSHCK-së duhet të veproj konform dispozitës së shënuar më poshtë të Ligjit për Konfliktin Administrativ i cili përcakton si vijon: Neni 36 1. *Nëse organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, si dhe në rastin nga neni 29 i këtij ligji nxjerr më vonë aktin administrativ, ky organ, përpos paditësit, do ta njoftojë edhe gjykatën.* 2. *Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të deklarojë nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm: 2.1. është i kënaqur; 2.2. nuk heq dorë nga padia; 2.3. pjesërisht heq dorë nga padia; 2.4. ai/ajo padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër.* 8 3. *Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerr në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk e jep deklaratën brenda afatit nga paragrafi 2. i këtij neni , gjykata do të nxjerrë vendimin mbi pezullimin e procedurës.* 4. *Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është ai/ajo i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.362/2020; datë 24.12.2020

Avdyl BEKTESHI



Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit 
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

